

TE MESUARIT DHE FAKTORET PERCAKTUES TE CILESISE SE TIJ: ANALIZE E ROLIT TE MESUESIT DHE TEKNOLOGJISE NE RRETHET GJIROKASTER, PERMET, TEPELENE.

Loreta Mamani

Universiteti European i Tiranës, Albania
E_mail: loretamamani@hotmail.com

Abstrakt

Ndonëse studiuesit pajtohen që teknologjia e komunikimit dhe informacionit ndikon mbi cilësinë e të mësuarit, ata ndahen kur vjen puna për të përcaktuar nëse cilësia e të mësuarit varet dhe ndikohet më shumë nga roli tradicional i mësuesit, roli i TIK, apo nga influenca e kombinuar e të dyve. Në çfarë shkalle rezulton atëherë se cilësia e të mësuarit reflekton rolin e mësuesit, të TIK, apo të dyve bashkë? Ky studim shqyrton procesin mësimor dhe të mësuarit në shkollat e rretheve Gjirokastër, Përmet, dhe Tepelenë. Synimi i tij është të analizojë dy çështje: 1) Cili është niveli i të mësuarit në shkollat e këtyre rretheve; dhe 2) Nëse niveli i vërejtur i të mësuarit është rezultat i rolit të mësuesit, shkallës së përdorimit të TIK, apo i influencës së kombinuar mësues-TIK. Analiza bëhet duke përdorur dhe testuar dy modele: një model që i jep përparësi rolit tradicional të mësuesit dhe modeli i dytë, është ai që i jep përparësi përdorimit të TIK. Duke përdorur parametrat e dy modeleve ky studim ka vëzhguar 3 gjetje: 1) se cilësia e të mësuarit vërtitet në nivele mesatare; 2) se modeli me mësuesin në qendër përdoret më shumë se modeli që i jep përparësi TIK; 3) se niveli i të mësuarit në shkollat që i japin përparësi rolit të mësuesit është më i lartë se në shkollat që disponojnë infrastrukturën dhe materialet mësimore TIK. Ky studim e shpjegon variancën në cilësinë e të mësuarit dhe influencën e mësuesit dhe TIK me argumentin se aplikimi i TIK, ndërsa mund të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së të mësuarit, mbetet i kufizuar në influencën e tij nëse nuk kombinohet me faktorin mësues. Bindjet dhe aftësitë e mësuesit në përdorimin e TIK influencojnë vetë rolin dhe fuqinë influencuese të TIK mbi të mësuarit. Ky i fundit, është më cilësor kur procesi mësimor është rezultat jo vetëm i rolit tradicional të mësuesit por edhe përdorimit dhe integritimit efektiv të TIK!

Key words: *të mësuarit, TIK, mësues, model mësimdhënieje;*